

Broshurë teknike

# ISOFLEX

## Material Iyerës hidroizolues elastomerik

### Përshkrimi

ISOFLEX është një membranë e lëngshme hidroizoluese, elastomerike me bazë uji. Ka ngjitje të shkëlqyer me nënshtresa të ndryshme, si betoni, druri, metali dhe çdo lloj membrane hidroizoluese, dhe mund të përdoret edhe në nënshtresa të parregullta. Pas mpiksjes, krijon një membranë të njëtrajtshme elastike hidroizoluese dhe të përshkueshme nga avujt, pa tegela apo fuga, duke ofruar:

- Elasticitet të lartë
- Rezistencë dhe qëndrueshmëri të lartë ndaj kushteve të motit
- Bardhësi e lartë dhe reflektimi diellor
- Përmirësimi i efikasitetit energjetik të ndërtesave duke ulur temperaturën e çatisë
- Mundësi përdorimi edhe në nënshtresa të paniveluara

Është çertifikuar me shënimin CE i cili e bën si shtresë mbrojtëse për sipërfaqet e betonit, sipas çertifikatës EN 1504-2. Numri i çertifikatës Nr. 2032-CPR-10.11.

### Fushat e përdorimit

ISOFLEX është ideal për hidroizolimimin e soletave, çative të harkuara etj. Përbën një zgjidhje të thjeshtë dhe të sigurt për hidroizolimimin e pjesëve të çative, p.sh. këndet, buzët dhe fugat midis materialeve të ndryshme të afërta, si dhe të plasaritjeve të izoluara.

Për më tepër, mund të përdoret edhe si bojë freskuese për soleta, për shkak të pasqyrimit të lartë të rrezeve të diellit.

### Të dhënat teknike

Ngjyrat:	e bardhë, e kuqërremtë
Fortësia sipas SHORE A:	50
Densiteti:	1.41 kg/l ± 0.02 kg/litër
Zgjatimi deri në këputje: (EN ISO 527)	600 ± 50%
Përthithja kapilare: (EN 1062-3, kërkesë e EN 1504-2: w < 0,1)	0,01 kg/m <sup>2</sup> ·h <sup>0,5</sup>

Përshkueshmëria nga CO<sub>2</sub>: S<sub>d</sub> > 50 m  
(EN 1062-6)

Përshkueshmëria nga avujt e ujit:  
(EN ISO 7783-2, kategoria I < 5m) S<sub>d</sub> = 0,80 m  
(e përshkueshme)

Ngjitja:  
(EN 1542, kërkesë për sistemet fleksibël pa trafik: 0,8 N/mm<sup>2</sup>) 1,3 N/mm<sup>2</sup>

Kushte atmosferike artificiale:  
(EN 1062-11, pas 2000 orësh) I kalon  
(nuk ka varje, plasaritje ose shtresëzim)

Reagimi ndaj zjarrit:  
(EN 13501-1) Euroclass F

Pasqyrimi i rrezeve diellore:  
(ISOFLEX white) 90%  
(ASTM E903-96)

Emetimi termik me infra të kuqe:  
(ISOFLEX white) ε = 0,86  
(ASTM E408-71)

Temperatura minimale e përdorimit: +5°C

Rezistenca ndaj temperaturës: nga -15°C deri në +90°C

Viskoziteti: ~ 80,000 mPa·s

Koha e tharjes në +20°C:  
(EN ISO 2811-1) 3 orë  
(prekje në të thatë)

Koha e rilyerjes në +20°C:  
(EN ISO 2811-1) 24 orë  
(prekje në të thatë)

### Udhëzimet e përdorimit

#### 1. Nënshtresa

Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e pastër, pa graso, grimca të lira, pa pluhur etj. Çdo zgavër ekzistuese në beton duhet të riparohet paraprakisht. Pas kësaj vijon Iyerja me astar, duke përdorur astarin ISO-PRIMER me një konsum rreth 200 g/m<sup>2</sup>.

# ISOFLEX

## 2. Përdorimi

### a) Izolimi total i sipërfaqes

ISOFLEX aplikohet në 2 shtresa me furçë ose me rul, pasi astari të jetë tharë. Dora e dytë duhet të jepet në formë kryq me dorën e parë, pasi ajo të jetë tharë.

Në zonat ku ka plasaritje të rënda, rekomandohet që ISOFLEX të përforcohet me shirit rrjetë me fibër xhami 10 cm të gjerë ( $65 \text{ g/m}^2$ ) ose me shirit me fibër poliestre ( $30 \text{ g/m}^2$ ) përgjatë plasaritjeve. Me pak fjalë, pasi astari (prajmeri) të jetë tharë, shtresa e parë e ISOFLEX aplikohet përgjatë plasaritjeve dhe ndërkohë që është e njomë, shiriti me fibër poliestre ose rrjeta me fibër xhami 10 cm e gjerë ngjishet për së gjati. Në vijim, aplikohen edhe dy shtresa të tjera me ISOFLEX në të gjithë sipërfaqen. Konsumi: rreth  $1,5 \text{ kg/m}^2$ , në varësi të nënshtresës.

Në rastin e plasaritjeve të dendura të shumëfishta që shfaqen në të gjithë sipërfaqen, rekomandohet që të përforcohet plotësisht membrana ISOFLEX me shirita 100 cm të gjerë me rrjetë me fibër xhami ( $65 \text{ g/m}^2$ ) ose me fibra poliestre ( $30 \text{ g/m}^2$ ). Shiritat e vendosur do të mbivendosen mbi njëri-tjetrin me nga 5-10 cm.

Me pak fjalë, pasi astari (prajmeri) të jetë tharë, një shtresë e parë e ISOFLEX aplikohet deri në përforcimin pasues, dhe ndërkohë që është e njomë, vendoset shiriti me fibër poliestre ose me rrjetë me fibër xhami. E njëjta procedurë aplikimi ndiqet edhe për pjesën e mbetur të sipërfaqes.

Në vijim, aplikohen edhe dy shtresa të tjera me ISOFLEX në të gjithë sipërfaqen.

Konsumi: rreth  $2,0\text{-}2,5 \text{ kg/m}^2$ , në varësi të nënshtresës dhe të llojit të përforcimit.

### b) Izolimi lokal i plasaritjeve

Në këtë rast, astari vendoset në nënshtresë me një gjerësi 10-12 cm vetëm përgjatë plasaritjeve. Pasi astari të jetë tharë, aplikohet fillimisht shtresa e ISOFLEX, dhe ndërkohë që është ende e njomë, ngjishet për së gjati një shirit 10 cm i gjerë me rrjetë me fibër xhami ( $65 \text{ g/m}^2$ ) ose një shirit me fibër poliestre ( $30 \text{ g/m}^2$ ).

Në vijim, aplikohen edhe dy shtresa të tjera me ISOFLEX përgjatë plasaritjeve duke mbuluar plotësisht të gjithë përforcimin.

Konsumi: rreth  $200\text{-}250 \text{ g/m}$  të gjatësisë së plasaritjes.

Veglat duhet të pastrohen me ujë ndërkohë që ISOFLEX është ende i freskët.

## Ambalazhimi

ISOFLEX ofrohet në kova metalike 1 kg, 5 kg, 15 kg, 25 kg dhe në fuçi 150 kg.

## Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim, në kova të izoluar dhe në ambiente pa ngrica, është minimumi 24 muaj.

## Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/CE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "i", lloji WB është  $140 \text{ g/l}$  (2010) për produktin e gatshëm për përdorim.

Produkti i gatshëm për përdorim ISOFLEX përmban maksimum  $1,66 \text{ g/l VOC}$ .

# ISOFLEX



2032

**ISOMAT S.A.**

17<sup>th</sup> km Thessaloniki – Ag. Athanasios  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

**12**

2032-CPR-10.11

DoP No.: ISOFLEX / 1408-02

**EN 1504-2**

Surface protection products

Coating

Permeability to CO<sub>2</sub>: Sd > 50m

Water vapor permeability: Class I (permeable)

Capillary absorption:  $w < 0.1 \text{ kg/m}^2 \cdot \text{h}^{0.5}$

Adhesion strength:  $\geq 0.8 \text{ N/mm}^2$

Artificial weathering: Pass

Reaction to fire: Euroclass F

Dangerous substances comply with 5.3

**ISOMAT S.A.**

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

**ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:**

Kilometri i 17<sup>te</sup> i Autostradës Selanik-Aj. Athanasiu 570 03

Tel. : 2310 576 002, Fax: 2310 576 029

**www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu**